

MALI I ZI



GJYKATA THEMELORE NË
ULQIN

**JENI DËSHMITAR APO
VIKTIMË E KRIMIT?**

*Njihni të drejtat dhe obligimet
tuaja*

Kjo broshurë është hartuar për të jua sqaruar atë që ju mund të prisni si dëshmitar ose viktimë e krimit, dhe në këtë mënyrë të përpiqeni të zvogëloni ankthin që mund të ndjeni gjatë procedurës penale.

EKSPERIENCA E DËSHMIMIT

Nëse ju raportoni krimin, ose nëse egziston një mundësi që ju mund të jepni informacione për një vepër penale, ju mund të dëgjoheni si dëshmitar nga prokuroria dhe gjykata. Gjithashtu, edhe i akuzuari mund t'ju kërkoj që të dëshmoni në favor të tij.

ÇFARË NDODH NËSE KAM MARRË FLETËTHIRJEN?

Fletëthirja është një urdhër e prokurorisë ose e gjykatës për t'u paraqitur, në kohën dhe vendin e përcaktuar në fletëthirje, në mënyrë që - si një dëshmitar – ta jepni deklaratën tuaj. Në fletëthirje duhet të ceket se thireni si dëshmitar. Kur ju e merrni fletëthirjen, ju duhet të paraqiteni para prokurorit ose para gjykatës, në mënyrë siç është e specifikuar në ftesë. Në rast se e merrni fletëthirjen, por nuk e arsyetoni mungesën e tuaj mund të urdhërohet sjellja e juaj me forcë dhe

gjithashtu mund të denoheni me gjobë deri në 1000 Euro.

Nëse nuk jeni në gjendje t'i përgjigjeni thirjes, njoftoni prokurorin ose gjykatën, para marrjes në pyetje, për arsyet e mosparaqitjes. Tregoni prokurorit ose gjykatës nëse keni ndonjë nevojë të veçantë për shkak të paaftësisë ose sëmundjes, ashtu që mund të konsiderohet mundësia e marrjes në pyetje në shtëpinë tuaj, spital apo në ndonjë vend tjetër të përshtatshëm.

Nëse ju punoni, punëdhënësi juaj duhet t'ju jap kohë të lirë që të merreni në pyetje si dëshmitar. Shpenzimet tuaja do të kompenzohen nga prokuroria apo gjykata.

PËRPARA GJYKIMIT

Në qoftëse prokurori e gjen si të pabazë të nis ndjekjen penale për krimin të cilin ju e keni paraqitur ose krimin ku ju ishit viktimë, ai është i obliguar t'ju lajmërojë në afat prej tetë ditësh dhe gjithashtu t'ju mësoj që ju vetë mund ta ndiqni penalisht dhe gjithashtu t'ju dorëzojë aktvendimin mbi refuzimin e kallëzimit penal. Në të njëjtën mënyrë do të veprojë prokurori në momentin kur ky do të bie urdhërin mbi ndërprerjen e hetimit dhe Gjykata kur të bie vendimin mbi ndërprerjen e procedurës për arsye të tërheqjes së Prokurorit nga ngritja e aktakuzës.

DËSHMIMI NË SEANCËN KRYESORE: Ç'FARË MUND TË PRES?

Caktimi i seancës kryesore të një çështje penale, varet nga obligimet ekzistuese të gjykatësit. Seancat kryesore mund të shtyhen për arsye të ndryshme, gjë që edhe ndodh shpesh. Procedura e parasheh që gjatë seancës kryesore kur ju dëshmoni Gjykata nga dhoma e gjyqimit i largon të gjithë dëshmitarët që ende nuk i kanë dhënë deklaratat. Në këtë mënyrë sigurohet që deklaratat e juaja nuk do të ndikojë në deklaratat e dëshmitarëve tjerë. Mos diskutoni mbi deklaratat e dëshmitarëve të cilët e kanë dhënë deklaratën përpara jush.

Në fillim të marrjes në pyetje nga ju do të kërkohen të dhënat personale. Para dhënies së deklaratës gjykatësi do t'jua tërheq vërejtjen, se jeni të obliguar të thoni çdo gjë që dini për çështjen e poashtu mund t'ju thërras të bëni betimin. Ajo që ju duhet të dini është që gjatë dëshmimit duhet të thoni të vërtetën dhe gjithashtu do t'ju tërhiqet vërejtja se dhënia e deklaratës së pavërtetë është vepër penale. Pasi do të jepni deklaratën të gjithë pjesëmarrësit në procedurë, përfshirë këtu edhe ekspertët gjyqsorë mund t'ju parashtrojnë pyetje, të cilat duhet të jenë të parashtruara qartë, me saktësi dhe pa mashtrime. Përgjigjet

tuaja mund të kontestohen, por ju duhet të dini se marrja në pyetje nuk ka të bëjë drejtpërdrejt me ju. Qëllimi është që të vihen në pah të gjitha aspektet e çështjes, sepse të gjithë trajtohen si të pafajshëm deri sa nuk vërtetësohet fajësia e tij me një aktgjykim të formës së prerë.

Mund të ndjeheni i nervozuar ose konfuz, gjë që është normale. Në qoftë se nuk e kuptoni pyetjen mos hezitoni që të thoni këtë – kërkoni sqarime. Në qoftë se jeni i stresuar i lodhur apo për shkaqe të tjera të arsyeshme mund të kërkoni pushim gjatë kohës së marrjes në pyetje. Palët në procedurë janë të obliguar që ndaj jush të sillen me respekt, dinjitet dhe përkujdesje, kurse gjykatësi t'ju mbrojtë dhe t'ju ndihmojë. Keni të drejtë të mos përgjigjeni në pyetje të prokurorit, avokatit apo gjyqtarit të cilat mund t'ju vënë në pozitë që të ndiqeni penalisht. Gjithashtu nëse jeni viktimë e dhunës seksuale nuk kanë të drejtë t'ju pyesin për jetën tuaj të mëparshme seksuale. Me këtë ju ju mbrohet intimiteti. Në rast se fëmija juaj i mitur është dëshmitar, duhet të veprohet me kujdes në mënyrë që marrja në pyetje e tij mos të ndikojë negativisht në gjendjen e tij psikike. Nëse është e nevojshme marrja në pyetje e të miturit do të bëhet në prezencën e psikologut ose ndonjë eksperti tjetër. Keni të drejtë që të jeni prezent kur fëmija juaj të merret në

pyetje, me përjashtim të rastit kur kjo nuk është në interes të procedurës apo të interesave të fëmijës.

Pas dëshmimit jeni të lirë të largoheni nga dhoma e gjykimit ose të rrini në publik në rast se gjykata nuk urdhëron ndryshe.

Në qoftë se zbatuesi i veprës penale nuk deklarohet se është fajtor ose në qoftë se nuk arrin një marrëveshje për pranimin e fajsisë me prokurorin, fajsia e tij verifikohet në seancën kryesore, kohën e mbajtjes të së cilës e cakton gjykata. Pas kësaj shqiptohet aktgjykimi. Mund të merrni pjesë edhe në këtë seancë kryesore.

A MUND TË JEM I/E MBROJTUR ?

Juve dhe familjes suaj (bashkëshortit/ bashkëshortes dhe të afërmeve) u janë në dispozicion forma të ndryshme të mbrojtjes. Keni të drejtë të kërkonit që t'ju sigurohet mbrojtja personale dhe materjale, para se të dëshmoni. Prandaj para se të filloni dëshmimin kërkonit që t'ju shpjegohet se cilat masa mbrojtëse ju janë në dispozicion. Gjykata është e obliguar që t'ju njoftojë për të drejtën në mbrojtje nga kërcënimi. Mbrojtjen mund ta fitoj secili dëshmitarë në qoftë

se ekziston një frikë e arsyeshme se me rastin e dhënies së deklaratës dhe me përgjigjen në disa pyetje do t'i rrezikohet seriozisht siguria e tij personale ose materiale, ose siguria e bashkëshortit/ es ose një të afërmi të tij.

Nga ju do të kërkohet që t'i tregoni arsyet përse kërkonit ndihmë dhe mbrojtje, kurse pranimi juaj është i nevojshëm për zbatimin e çdo forme të mbrojtjes.

Nëse mosdhënien e deklaratës e konsideron si të pabazë organi që drejton procedurën do t'ju tërheq vërejtjen në mundësinë e shqiptimit të një denimi si p.sh. në rastin e mos përgjigjes në thirrje.

KOMPENSIMI I DËMIT TË SHKAKTUAR NGA ZBATIMI I NJË VEPRE PENALE

Nëse ju keni pësuar një humbje, një dëmtim ose një dëm për shkak të zbatimit të një vepre penale ju keni të drejtë të kërkonit kompensim dëmi (ligjërisht të definuar si kërkesë juridiko-pronësore). Dëmi i pësuar për shkak të zbatimit të një vepre penale mund të jetë material dhe jomaterial. Dëmet materiale i referohen humbjes ose zvogëlimit të pronës suaj apo parandalimit të rritjes së saj (humbje fitimi) për shkak të kryerjes së një vepre penale. Dëmi jomaterial i

referohet dhimbjes psiqike ose fizike ose frikës të shkaktuar me zbatimin e një veprë penale. Përveç kompenzimit për dëmin material ose jomaterial, kërkesa juridiko pronësore mund t'i referohet edhe kthimit të sendeve në rast se ato ju janë grabitur me rastin e zbatimit të veprës penale dhe me anulimin e punës juridike si p.sh në rast se kontrata është e paligjshme. Keni të drejtë të angazhoni një avokat gjatë procedurës penale.

Ç'FARË DUHET TË BËJË?

Nëse ju raportoni një krim cekni të gjitha dëmtimet humbjet apo dëmet të shkaktuar nga zbatimi i kësaj veprë penale.

Gjatë marrjes së juaj në pyetje si dëshmitar prokurori dhe gjykata janë të obliguar që t'ju pyesin në qoftë se ju doni të paraqisni një kërkesë juridiko-pronësore, në rast se zbatuesi do të ndiqet penalisht. Në këtë rast duhet t'ju shpjegohet çka nevojitet për parashtrimin e një kërkesë juridiko-pronësore. Kërkoni për t'ju sqaruar çdo gjë që nuk e keni të qartë. Është e rëndësishme që t'i theksoni të gjitha shpenzimet, çdo humbje fitimi dhimbje dhe vuajtje që pësuar për shkak të zbatimit të veprës penale. P.sh. shpenzimet e trajtimit mjekësor ose shpenzimet të cilat kanë lindur për shkak të riparimit ose ndrimin të pronës

suaj kështu ju do të ndihmoni në përcaktimin e të gjitha fakteve të nevojshme për të marrë vendimin mbi kërkesën tuaj juridiko-pronësore. Gjithashtu duhet t'i ruani dhe t'i prezantoni të gjitha vërtetimet, parallogaritë ose çdo dokument tjetër, nëse janë në dispozicionin tuaj, për të mbështetur kërkesën tuaj juridiko-pronësore.

DORËZIMI I KËRKESËS JURIDIKO-PRONËSORE

Kërkesa juridiko-pronësore shqyrtohet vetëm me kërkesë të personit të autorizuar, propozimin mund t'ia dorëzoni prokurorit gjatë hetimit ose gjykatës gjatë gjykimit dhe mund të dorëzohet jo më vonë se përfundimi i seancës kryesore. Nëse është e mundur është e rëndësishme që të deklaroheni mbi vlerën e kërkesës suaj juridiko-pronësore dhe të keni provat për dëmin e shkaktuar.

DORËZIMI I KËRKESËS JURIDIKO-PRONËSORE GJYKATËS

Nëse ju nuk keni dorëzuar një kërkesë juridiko-pronësore pranë prokurorisë, gjykata përsëri do t'ju njoftojë gjatë gjykimit që këtë të drejtë mund ta shfrytëzoni përpara gjykatës.

Në rast se prokurori dhe i akuzuari arrijnë një marrëveshje për pranimin e fajësisë dhe gjykata e pranon atë, gjykata duhet t'ju informojë për këtë.

Pas prezantimit të të gjitha provave, dhe para shqiptimit të aktgjykimit ju keni të drejt që ta prezantoni fjalën përfundimtare në këtë çështje.

Kur shqiptohet aktgjykimi keni të drejt të fitoni një kopje të tij. Ju mund të apeloni aktgjykimin, por vetëm në lidhje me vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale, përveç në rastin kur prokurori publik mori përsipër ndjekjen penale nga i dëmtuari, si paditës, ose në qoftë se u shqiptua një aktgjykim për

lirimin e të akuzuarit me çrast i dëmtuari mund të apeloj mbi të gjitha bazat.

Nëse i akuzuari shpallet fajtor, aktgjykimi duhet të përfshijë edhe vendimin për kërkesën juridiko – pronësore, të cilën ju e parashtruat gjatë procedurës penale. Përrjashtimisht, dhe për shkaqe të arsyeshme, gjykata mund t'ju drejtojë që kërkesën juridiko – pronësore ta arrini përmes një procedure civile.

Nëse gjykata liron të akuzuarin, refuzon padin ose ndërpret procedurën, do t'ju informojë në lidhje me mundësinë që kërkesën juridiko – pronësore ta arrini përmes një procedure civile.

Pavarësisht nëse i akuzuari është dënuar ose jo, ju mund të ngreni një padi civile dhe të kërkonit zhdëmtim.

GJYKATA THEMELORE NË ULQIN

Adresa: rr. Boshko Strugar, Ulqin,
Mali i Zi

Tel. 030/412 026, 412 071,

Faks. 030/421 251

Web faqja e gjykatës:

<http://sudovi.me/osul>

Orari i punës së Gjykatës:

E hënë - E premte

ora 08,00-16,00

Orari i punës së regjistrit të Gjykatës

E hënë - E premte

ora 11,00-14,30



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE

Ky doracak është realizuar me mbështetjen e popullit amerikan, nëpërmjet Agjencisë Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar, Programi i menaxhimit efikas në Mal të Zi.

E drejta e autorit në imazhet: Studio Mouse, Podgoricë. Përgatitja dhe printimi: Studio Mouse